

## AKT THEMELIMI DHE STATUT

### I SHOQËRISË

“ XPRESS GUARDS SECURITY SHPK ”

#### KAPITULLI I

KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA

#### NENI 1 KRIJIMI I SHOQËRISË

Sot ne date 21/ 10 / 2024 themelohet shoqeria me perjegjesi te kufizuar me emertimin “ XPRESS GUARDS SECURITY SHPK ” (Me poshte referuar si “Shoqeria”).

1. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe funksion ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ” te ndryshuar.
2. Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar qe prej dates, ne te cilin organet kompetente kane dhene aprosimativ per themelimin e saj.
3. Shoqeria e ushton aktivitetin e saj ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluesc.

#### NENI 2 FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqeria do të ketë formën e shoqërisë me perjegjesi te kufizuar, për sa kohë që Ortaket e kesaj shoqerie nuk do të marrin një vendim për shndërtimin e saj.
2. Veprimitaria e shoqërisë do të irregullohet sipas radhes nga dispozitat e ketij statuti dhe dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregtare”, te ndryshuar, per aq kohe sa dispozitat e ketij statuti nuk vijnë ne kundershtim me ligjin e mesiperm.

#### NENI 3 EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është **Xpress Guards Security shpk**. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar” ose inicialet sh.p.k .

#### NENI 4 SELIA E SHOQERISE

Gjergji Shkota  
W.P.K.

1. Shoqëria e ka selinë ne qytetin e Vores , ne adresen : **Frashnjet 03890033 , Nd nr 16 , Hyrja I Binxolle 1053 Vore Tirane .**
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblese se Ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
2. Në përputhje më këtë statut, shoqëria mund të mbylli veprimtarinë e saj ne cdo kohe e kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

**NENI 6**  
**QUELLIMI DHE OBJEKTI**

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë eshte:

**Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike , Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit , Import – eksport dhe tregti te mallrave te ndryshem , veprimtari ne fushen hoteleris e turizmit ,energjikës dhe veprimtari te tjera te lejuara nga ligji .**

2. Shoqeria mund te ndryshoje dhe te shtoje ne cdo kohe objektin e veprimtarise se saj sipas rregullave te parashikuara ne statutin e saj dhe ne legjislacionin tregtar.

**KAPITULLI 11**


**KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

**NENI 7**  
**KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren 1,000,000 (nje miljon) leke. Ai mund te rritet me vendim te asamblese se per gjithshme te ortakut te vetem sipas normave te fushes ne fuqi.

**NENI 8**  
**ORTAKET DHE KUOTAT**

Shoqeria perbehet nga 1 ortak. Ortaku i vetem i shoqerise eshte znj. Gjergji Shaka i biri i Spiros shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, banues ne adresen ; **Njesia Administrative nr 2 ,Rruga Skerdilajd Llagami Nd 3,H 1,Ap1, 1010 Tirane, me numer**



identifikimi personal, H20314155G. Ortaku i vetem Zoti Gjergji Shaka , zoteron 1 kuote ne masen 100%, me vlerë 1,000,000 ( një milion ) leke

## N E N I 9 MENYRA E FITIMIT DIJE KALIMIT TE KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit shoqerise e te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
  - a. Kontributit te ortakeve ne kapitalin e shoqerise;
  - b. Shitblerjes;
  - c. Trashigimise;
  - d. Dhurimit;
  - e. Çdo menyre tjeter parashikuar ne ligj.
2. Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se emimit, rregullohen nga kontrata.
3. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.
4. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord ne kontrate, vlefshmoria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ, pershi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.
5. Me perjashtim te kalimit te kuotave nepermjet trashigimise, ne rastet e tjera ortaket duhet te miratojne me vendim te asamblese, transferimin e kuotave jashtë shoqerise. Pas momentit te kalimit te kuotave me ane te trashigimise, per trashigimtaret zhatoonen dispozitat e parashikuara ne pikën 3-10 te ketij nenii.
6. Ortaket ne rastin kur mendojne qe te transferojne pjeserisht apo teresisht kuotat e tyre nepermjet shitblerejces duhet te kryejne proceduren e parablerjes se koutave ndaj te ortakeve te tjere. Afati qe secili nga ortaket duhet te vleresoje oferten eshte 90(nentedhjete) dite kalendarike nga data e marrjes se ofertes.
7. Oferta duhet te dergohet ne forme te shkruar (poste rekomande) dhe ne forme elektronike (email), ne adresen e scililit ortak te rregjistruar prane shoqerise. Ortaku detyrohet te depozitoje ndryshimet e adreses se banimit prane shoqerise. Ne rastin qe ortaken nuk e kane depozituuar ndryshimin prane shoqerise, ortaku qe kerkon te shese ose transferoje mund te njoftoje direkt ne adresen e shoqerise, ndaj prezumohet qe ortaket e tjere, kane marre dijeni brenda 7 diteve nga dita e mbritjes se njoftimit ne adresen zyrtare te shoqerise.
8. Oferta duhet te permbojte daten, adresen e sakte te ortakut qe i drejtohet, numrin e kuotave qe kerkon te disponojo, emimin e ofruar per kuote dhe/ose ne total, formen e monedhes (nese eshte ndryshe nga ajo e kapitalit te rregjistruar te shoqerise) dhe kursin e kombinimit, kushtet e shitjes, afatin e kthimit te pergjigjes, adresen e sakte (vendin ku ortaku/et do qe te vijnë pergjigjet e ofertave dhe emailin) te ortakut qe kerkon te shese kuotat. Mosrespekimi i ketyre elementeve e ben oferten te pavlefshme. Nese ortaku nuk vendos adrese ne oferte, atchere adresa eshte vendbanimi i tij zyrtar i rregjistruar ne gjendjen civile, te percaktuar ne kete staut. Nese njoftimi i eshte derguar ne kete adrese, konsiderohet qe ai eshte njoftuar.

Gjergji Shaka  
MSH

9. Nese ortaku apo ortaket e shoqerise e pranojne oferten ne kushtet e parablerjes, ata duhet te shprehesh qarte dhe hapur per vullnetin e tyre te lire dhe te pakushtezuar ne pranimin e ofertes.
10. Ne rast se ortaku brenda 60 diteve kalendarike refuzon oferten osc nuk shprehesh fare ne lidhje me te, atchere procedura e parablerjes konsidrohet e kryer dhe ortaku eshte i lire qe te shese koutat e tij jasht shoqerise me nje vlore te barabarte ose me te madhe se ajo e paraqitur ne oferte.
11. Ne edo rast, asambleja e ortakut te vetem duhet te miratoje shitjen e kuotave jasht shoqerise me shumice te cilesuar me anetaret qe janc prezente ne mbledhje, ne kete rast, vota e ortakut qe kerkon te shese kuotat, perjashtohet nga votimi.
12. Ndaloher shitja dhe/ose dhurimi i kuotave ndaj personave fiziko apo juridike, veprimtaria e te cileve eshte ne konkurence me shoqerine dhe duket hapur qe dhurimi apo shitja e tyre demton veprintarine e shoqerise. Perjashtohet rasti, kur te gjithe ortaket e shoqerise, edhe pse sa me siper duket hapur, ata jane shprehur me vendim qe jane dakort mc shitjen apo dhurimin e kuotave. Ne kete vendim, nuk perfshihet ortaku qe kerkon te shese apo dhuroje kuotat e tij.
13. Nesc ortaket e tjere nuk ushtrojne te drejten e parablerjes, vec e vec dhe/osc sebashku, sipas afateve te peraktuara me lart, ortaku shites eshte i lire qe kuotat e ofruara t'ia shese te treteve, brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike, nga mbarimi i afatit prej 60 ditesh kalendarike osc nga dita e kthimit te perggjigjes negative nga ortaket e tjere.
14. Ne rast se te gjithe ortaket pranojne oferten e ortakut, atehere vlera e kuotave qe jane nxjerre ne shitje, ndahet ne perpjestim te drejt, me perqindjen e ortakeve te tjere ose te barabarte nesc kuotat jane te shperndara ne menyre te barabarte.
15. Ne rast se ortaku qe kerkon te shese koutat e tij pjescisht apo plotesisht deshton ne shitjen e tyre dy here radhazi, keto kuota mund te anullohen ose te likuidohen, me miratimin e ortakut, sipas nenit 80 te Ligjit nr.9901, date. 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare". Ne edo rast, anullimi dhe likudimi i kuotave ne hale shoqerohet mc vendim te Asamblese se Pergjithshme, vendimi per anullimin ose likujdimin duhet te merret me shumice te cilesuar te anetareve prezente ne mbledhjen e asamblesc.
16. Kuotat qe shiten kane vleren fillestar te rregjistrimit te kapitalit fillestar, nese shoqeria deri ne momentin e fillimit te procedures se shitjes nuk bere rritle kapitali sipas ligjit dhe te rregjistruar ne QKB.

## N E N I 10

### **PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE**

1. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e perfiton ate, perggjigen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe njedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit, sipas pikes 2 te nenit 74 te Ligjit Per shoqerite tregtare.
2. Shoqeria realizon kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
3. Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise. Rregulli i kushtezimit te transferimit nuk zbatohet ne rast te transferimit per shkak trashegimic ose transferimit tek pjesctaret e familjes.

### **K A P I T U L L I    III** **MARREDITENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE**

*Gjergji Shala*  
*J.S.*

## NENI 11

### **SHPERNDARJA E FITIMEVE**

- Ortaket kane te drojte te ndajne sipas perqindjes se pjesemarrjes ne shoqeri, pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise dhe te miratuara nga nje ekspert kontabel i miratuar dhe prej asamblese se ortakeve me vendim. Shoqeria mund te mos ndaje fitim edhe kur realizon fitim, nese mbledhja e asamblese ka vendosur per kete qellim.
- Administratori i shoqerise ne rastin e shperndarjes se fitimit duhet qe dokumentin perkeates qe autorizon strukturen perkatese per kalimin e fitimeve ndaj ortakeve te shoqerise, ta shoqeroje me vendimin perkates te asamblese, i cili miraton ne parim shperndarjen e vendimeve.

## NENI 12

### **KUFIZIMET E SHPERNDARJES, ÇERTIFIKATA E AFTESESE PAGUESE, PERGJEGJESITE**

- Shoqeria mund tu shperndaje fitim ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividentit:
  - Aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
  - Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12-muajve ne vazhdim.
- Administratori leson nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividenteve perm bush kerkesat e paragrafit te pare te ketij nen, ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividenteve nuk i perm bush keto kriteri, administratori nuk mund te leshoje kete certifikate.
- Administratori per gjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates te aftesise paguese.
- Administratori, i cili nga pakujdesia leson nje certifikate te pasakte te aftesise paguese, per gjigjet personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividenteve te shperndare.
- Ortaket, qe kane mare nga shoqeria divident, per gjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividenteve, pavaresisht leshimit te certifikates, nesc keta ortake kanc pasur dijeni per gjendjen e pa aftesise paguese te shoqerise sipas paragrafit te pare te ketij nen.

## KAPITULLI IV

### **ORGANET DREJTUESE TE SHOQËRISË**

Organet drejtuesc te shoqerise janë:

- Asambleja e per gjithshme e ortakut te vetem
- Administratori

### **ASAMBLEJA E PER GJITHSHME E ORTAKUT TE VETEM**

#### NENI 13 **TE DREJTAT DHE DETYRAT**



1. Asambleja e pergjithshme e ortakut te vetem eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshteme :

  - a) Pereaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
  - b) Ndryshimet e statutit;
  - c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit ;
  - d) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
  - e) Pereaktimin e siperblimeve per personat e permendur ne shkronjat e dhe d, te kesaj pike ;
  - f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise ;
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise ;
  - h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
  - j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit ;
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ;
  - l) Për miratimin e marrjes së audituesve te jashtem, në rastet e hetimeve te posacime;
  - m) Miratimin e struktura se shoqerise dhe nivelet e pagave per vend pune;
  - n) Shperndarjen e fitimeve per ortaket;
  - o) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
  - p) Miratimin e marrjes se kredive bankare;
  - q) Krijimin dhe perdorimin e fondit rezerve te shoqerise;
  - r) Shnderrimin e formes se shoqerise dhe/ose bashkimin me shoqeri te tjera, apo pjesemarrjen ne shoqeri apo grupje shoqerish;
  - s) Miratimin e formes, permbajtjes dhe perdorimit se rregjistrat te shoqerise per rregjistrimin e vendimeve te shoqerise, dhe strukturen per gjegjese per administrimin e tij;
  - t) Miratimin e rregulloreve te ndryshme te punes si dhe rregulloreve te tjera qe ne thelb kane te bejne me procese te rendesishme te veprimitarise se shoqerise ;
  - u) Miratimin ne rastin e shitblerjes se koutave te orlakeve osc formave te tjera te transferimit te tyre, sipas parashikimeve te ketij statuti.
  - v) Miratimin ne rastet e dhenies apo marrjes me qira te sendeve prodhuese te luajtshme.
2. Duhen regjistruar ne veçanti ne Qendren Kombetare te Biznesit, por pa u kufizuar ne to, vendimet e asamblese per :

  - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise;
  - b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
  - c) Investime;
  - d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
  - e) Vendime te tjera qe asambleja e pergjithshme vlereson se duhen rregjistruar.
3. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve janë absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perycc rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rethowane te qarta nuk mund te kishte pasur dijeni per te .

**NENI 14**

**MBLEDIIJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSIIME E ORTAKUT TE VETEM**

- Asambleja e Përgjithshme e Orakut te Vetem mblidhet në rastet e përaktuara nga ligji "Per shoqrite tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së Orakut te Vetem thirret të paktën 1 herë në vit.
- Asambleja e Përgjithshme e Orakut te Vetem thirret nga administratori dhe/ apo ortakët e përaktuar sipas nenit 84 të ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Nr. 9901, dt. 14.04.2008 te ndryshuar.
- Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem duhet te thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem duhet thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponoje në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem duhet te thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Në rastet e parashikuara në pikat 3 c 5 të këtij neni, asamblea së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet sipas pikave 4 c 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.
- Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem mund të miratojë një rezolutë këshillucse, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimitarët e administratorit.

#### **NENI 15** **MENYRA E THIRRJES**

- Asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë poste rekomande dhe me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e 1-të dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtate) ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Materialet e mbledhjes të përaktuara në rendin e ditës duhet të dërgohen jo me vonë se 3 (tre) ditë nga dita e caktuar për zhvillimin e mbledhjes, në formë elektronike dhe me shkresë. Mosdërgimi i tyre në kohë konsiderohet si shkelje procedurës për thirrjen e asamblesë dhe mbledhja konsiderohet e pavlefshme, me përshtim të rastit kur të gjithë ortakët janë të pranishem ne mbledhje dhe janë dakort me mosbatimin e kësaj dispozite.
- Kur asambleja e përgjithshme e Orakut te Vetem nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendim e vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **NENI 16** **KERKESAT NGA ORTAKET E PAKTËS**

- Ortakët, të cilët përsaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë posilën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse

*Gjergj Shuka*  
*WAF*

- kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e këruar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, sësili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
    - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratori nuk përbush kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
    - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
  2. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni thirrja i çështë njostuar ortakëve, administratori njoffon përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.
  3. Ndryshimet në rendin e ditës si rregull lejohen të bëhen jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e marijes së njoffimit të zhvillimit (ë mbledhjes). Në cdo rast, para fillimit të mbledhjes lejohet që ortakët e pranishem, ne unanimitet mund të bëjnë ndryshime në rendin e ditës.
  4. Përfaqësuesi i autorizuar çështë i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrëthanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesat tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

#### NENI 17 PERFAQESIMI NE ASAMBLE

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi (ne rastet kur ortaku eshte person juridik) osc prokure të posacme (ne rastet kur ortaku eshte person fizik) nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Në cdo rast përfaqësimi të një apo disa ortakëve, drejtuesi i mbledhjes së asamblesë duhet të verifikojë ligjshmërinë e autorizimit të përfaqësimit. Perfaqësuesit e autorizuar do të pranohen në mbledhje veten nese autorizimi i tyre ploteson kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar mbi perfaqësimin.
2. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### NENI 18 KUORUMI PER VENDIMET ME SHUMICE TE THJESHITE

1. Ne rastin e marjes se vendimeve që kërkojnë shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë me shume se 50% (pesedhjete) te kuotave.
2. Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose per çeshtje që kërkojnë shumice te cilesuar, që parashikohen ne nenin 87 te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare", kuorumi i nevojshem eshte ai i përcaktuar ne nenin 19 te ketij satuti.
3. Nese asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet, per shkak te mungesës se kuorumin ne pikën 1 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### NENI 19 KUORUMI

## PER VENDIMET ME SHUMICË TË CILËSUAR


1. Asambleja merr vendim me  $\frac{1}{4}$  (tre të katërtat) kur marrin pjesë ne mbledhje ortaket me te drejtë vote që zoterojne me shumic se 75 (shtatedhjetë e pese)% të kuotave te shoqërisë, në rastet e mëposhtme:
  - a) për ndryshimin e statutit,
  - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
  - c) shpërndarjen e fitimeve,
  - d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,

### NENI 20 **MARRJA E VENDIMEVE NDAJ ORTAKËVE**

Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrimet shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kusizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, nuk kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### NENI 21 **E DREJTA E VOTES**

1. Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjeshetim me vleren nominale te kuotes se tij. Bashkezoteruesit e nje kuote ushtrojne te drejtat e votes bashkerisht, sipas nenit 72 te ligjit.
2. Ortakët, që nuk mund të janë të pranishëm fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja e asamblesë së përgjithshme kanë të drejtë që të përfaqësohen, ose të marrin pjesë nëpermjet, mjeteve të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet plotësia identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kusfuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellëtë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjeter;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpala apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhë sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve. Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes ndodh që të ndërpritet komunikimi mes ortakut/vc me mbledhjen për arsyec teknike apo të forcave madhore, dhë ortaku apo ortakët nuk kanë përfaqësuesit e tyre fizikisht në vendin ku zhvillohet mbledhja, atëherë vendimarija do të konsiderohet e rregullt për aq kohë sa ishte vendosur lidhja e drejtpërdrejtë me mbledhjen me ortakun dhc/ose ortakët, gjë e cila duhet shënuar në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja me nje shumicë mbi 50 % te kuotave mund te vendose perpara zhvillimit te mbledhjes, që ne mbledhje te caktuara te asamblese te jete prezent dhe nje noter publik.



5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo ky statut, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

### NENI 22 **PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

1. Ortaku nuk mund t'u ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padic ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënen osa jo të përsitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### NENI 23 **PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Prosesverbalit duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Prosesverbalit i bashkëlidhet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Prosesverbalit i mbledhjes nënshkruehet nga kryetari, nga mbajtësi i procesverbalit (sekretari) dhe të gjithë ortakët e pranishëm në mbledhje ose përfaqësuesit e tyre. Drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin që të lejojë ortakët që të kenë të gjithë kohën e nevojshme që të shqyrtojnë procesverbalin e mbledhjes. Drejtuesi i mbledhjes ka detyrimin që të perpiloje aq kopje origjinale sa ortake janë të pranishëm ne mbledhje.
5. Pas nenshkrimit te procesverbalit, duhet te pergalet vendimi i mbledhjes, i cili duhet te permboje midis të tjera, numrin e radhes, daten e mbledhjes ku eshte marrë vendimi, bazen ligjore dhe statutore, pjesemarrjen dhe kuorumin, vendin e mbledhjes, shprehjen e qarte te asaj që ortakët kane rene dakort ose jo, pozicionimin e tyre sipas çdo pike te rendit te dites mbi te cilën eshte marrë një vendim, nenshkrimin e ortakeve pjesemarres, ne rastin kur janë persona fizike dhe vulen e shoqerise kur janë persona juridike. Vendimi mund te zharkohet (hartohet, lexohet dhe nenshkruehet dhe/ose vuloset nga të gjithë ortakët e pranishëm), diten e mbledhjes ose ne ditet ne vijim, por ne asnjë rast me vone se 10 (dhjetë) ditë pas perfundimit te mbledhjes. Vendimi i asamblese se ortakeve eshte i detyrueshem te bëhet dhe nenshkruehet (emer, mbiemer, nenshkrim, dhe vule nese ortaku eshte person juridik) ne fund te tij, ne aq kopje origjinale sa janë ortakët pjesemarres, dhe te pakten dy kopje origjinale te tjera. Vendimi si rregull nenshkruehet nga edo ortak, ne secilën faqe, nesc ka me shume se një faqe. Njera prej tyre duhet te mbahet nga administratori, per tu rregjistruar dhe depozituar ne arkiven e shoqerise. Kopja/et e tjera mund te perdoren per rregjistrim, nese vendimi i asamblese se




pergjithshme eshte parashikuar nga statuti dhe/ose nga ligji si rast i detyrueshem rregjistrimi, pranc QKB apo institucioneve publike dhe/ose jopublike qe e kerkojne nje gje te tille.

6. Nje kopje e vendimeve mund tu dergohet me poste dhe ne forme elektronike ortakeve te cilat nuk kanë qenë pjesëmarres ne mbledhje, per tu vone ne dijeni me vendimet e asamblese se pergjithshme.
7. Nese shoqeria ka publikuar një faqe në internet, administratori, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, eshte i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe kur ka marre fillimisht qe ne mbledhjen perkatese te asamblese miratimin per publikim per çdo mbledhje ne veçanti.

#### NENI 24 **HETIMET E POSAÇME**

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçem për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës, i cili miratohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas parashkimeve te ketij statuti.
2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit.
3. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nese asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.
4. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçem dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojoë hetimin e posaçem në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët c përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.
5. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqeria tregtare përballon kostot e emëritit dhe të shpërbllimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçem.
6. E drejta për të kërkuar hetim të posaçem, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.
7. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

#### NENI 25 **SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DIJE DEMSHPERBLIMI**



1. Asambleja e per gjithshme, ne baze te nje vendimi te marre me shumicen e percaktuar sipas pikes 2, nen 87, te ligjit, ka te drejte te ngreje padi perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, si pasoje e shkeljes se rende te ligjt ose te statutit dhe/ose padi te tjera qe parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.
2. Ortaket, te cilet perfaqesojne te paktën 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise ose njc vlore me te vogel, te parashikuar ne statut, dhe/ose kreditoret e shoqrise, te cilet pretendojne se shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlore jo me te vogel se 5 per qind te kapitalit, mund t'i kerkojne asambles se per gjithshme ngritjen e padise per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve. Ortaket apo kreditoret e shoqerise se percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrine drejtperdreji, perpara gjykates kompetente, padi ne emer te shoqerise, per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e per gjithshme nuk merr nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkesës, kerkesa e ortakeve apo kreditoreve te percaktuar me siper vleresohet e refuzuar."
3. Asambleja e per gjithshme ka te drejtë t'i kerkojë gjykates perkatëse shfuqizimin e vendimeve te administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje te rëndë te ligjt ose të statutit.
4. Ortakët, te cilët përfaqësojnë te paktën 5 për qind te totalit te votave në asamblenë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël te parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve te shoqërisë mund t'i kerkojnë asamblesë së per gjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së perçaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë te drejtë te ngrënë padi drejtpërdrejt perpara gjykates kompetente për shfuqizimin e vendimit te administratorëve. Nëse asambleja e per gjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kerkesës, kerkesa e ortakëve apo kreditorëve vleresohet e refuzuar.
5. Në rastet kur shoqeria ngrine padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi te posaçem, te caktuar nga asambleja e per gjithshme.
6. Ortakët ose kreditorët e përmendorur në pikën 2 te këtij nen mund t'i kerkojnë gjykates zëvendësimin e përfaqësuesit te posaçem, kur ka dyshime te bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e per gjithshme mund te mos ngruje e ndjekë padinë në interesin më te mirë te shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kerkesh, kostot e emërimit dhe te shpërblimit te përfaqësuesit përballohen nga shoqeria.
7. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmorisë së vendimit te administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçem për korrigjin e pasojave te vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit te këtij përfaqësuesi. Te drejtat e palëve te treta mbeten te pacenuara, në përputhje me pikën 3 te nenit 12 te këtij ligji.
8. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e perçaktuar më sipër kanë te drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 te këtij nen, edhe në rastin kur asambleja e per gjithshme nuk merr vendim, ose refuzon te vendosë për kerkeshën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve te padisë, me objekt shpërblimin e dëmit te pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive te tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

*Gjergj Shala  
A.P.*

9. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" zbatohet edhe për këto padi.

**NENI 26**  
**TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN**

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

**NENI 27**  
**NDALIMI I KUFIZIMEVE**

1. Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 te ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.
2. Vendimet e asamblesës së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**ADMINISTRATORI**

**NENI 28**  
**EMERIMI, SHKARKIMI, TE DREJTAT DHE DETYRIMET**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emerimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pese) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Pergjithshme merr vendim te posacem per riemerimin e Administratorit pas periudhes se emerimit të pare. Emerimi i administratoreve, i cili hyn ne fuqi ne daten e përcaktuara sipas aktit te emerimit, u kundrejtohet paleve te treta sipas percaktimeve te nenit 12 te ligjit tregtar.
2. Administrator i shoqerise eshte Zoti .Hysen Drazhi , shtetas shqiptar, lindur ne 15/07/1968 , madhore, me zotesi juridike per te vepruar, banuese ne Vore , ne adresë Rruga Repartit , ndertesa nr 39 hyrja nr 1 Domje , Berxulle 1053 Vore Tirane, me numer identifikimi personal, G80715169A .
3. Drejtues Teknik i shoqerisë Emerohet Zoti Naim Toçilla shtetas shqiptar,lindur me dt 23/01/1968 , madhore, me zotesi juridike per te vepruar,banues ne Tirane ne adresen ;Rruga Llazi Miho , Pallati nr 159 , shkalla 2 Hyrja 22 Kombinat Tirane , me numer identifikimi personal , G80123152E .

*Yerjqi Shoko  
M. A. S.*

- asamblec e pergjithshme per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.
5. Nese asambleja e pergjithshme nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e peraktuar ne thirrjen e kryer nga administratori i dorehequr, atchere administratori i njofton me shkrim dorcheqjen Qendres Kombetare te Regjistrimit, se bashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblec se pergjithshme dhe Qendra Kombetare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.
  6. Dorcheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkclje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj, sipas kctij ligji."

Administratori ka te drejtë e detyrohet te:

- a) kryejë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare ne marredhenie me te tretet;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
- d) njoftoje ortaket per mbledhjen e shoqerise me kerkese te tij ose te njerit ose disa prej ortakeve;
- e) mbaje nje rregjister te vecante ku te beje rregjistrimin e te gjitha vendimeve te Asamblese se Pergjithshme. Te mbaje te gjithe dokumentacionin e nevojshem qe duhet per cdo mbledhje, pervec te tjera, njoftimin per thirrjen e mbledhjes, procesverbalin dhe vendimin e asamblese te nenshkruar nga te gjithe ortaket pjesemarres, dhe dokumentat shoqeruese qe janc diskutuar ne mbledhje;
- f) mbaje lidhje te ngushta me ortaket dhe te respektoje etiken ne komunikim dhe marredhenie me ta.
- g) lidhje kontratat e punes me punonjesit e shoqerise;
- h) mbaje korespondencë te rregullt me te tretet, si dhe te marre te gjitha masat qe kjo te jete e arkivuar ne arkiven e shoqerise;
- i) siguroje akses te lire dhe te pakushtezuar per secilin prej ortakeve, qe te njihet me cdo dokument qe keta te fundit e vleresojne te rendesishme ne mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise;
- j) raportoje me shkrim ndaj asamblec se pergjithshme per veprimtarine tremujore te shoqerise, cdhe nese asambleja apo secili prej ortakeve nuk e ka kerkuar shprehimi qe kete raport. Ky raport duhet te dergohet me shkrim dhc i nenshkruar nga administratori, zyrtarisht me poste dhe/ose me poste elektronike, ne adrese te ortakeve te shoqerise.
- k) përgatise dhe nenshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhc raportin e ecurisë se veprimtarisë, dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparras asamblesë se përgjithshme përmiratim;
- l) krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- m) kryejë regjistrimet dhe dërgojë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- n) raportojë përparras asamblesë se përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtarc;
- o) kryejë detyra te tjera te përaktuara ne ligj dhe ne kete statut.

Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhc shoqerite tregtare", administratori eshte i detyruar të thërrase asamblenë e përgjithshme.

5.Drejtues teknik i shoqeris emerohet Zoti ; Drejtues Teknik i shoqeris Emeryhet **Zoti Naim Toçilla** shtetas shqiptar,lindur me dt 23/01/1968 , madhore, me zotesi juridike per te vepruar,banues ne Tirane ne adresen ;Ruga Llazi Miho , Pallati nr 159 , shkalla 2 Hyrja 22 Kombinat Tirane .

### **NENI 29** **PERFAQESIMT**

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtoshen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.
2. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhc çdo ndryshim i tij njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **NENI 30** **SHPERBLIMI**

1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa. Shtesat bëhen me vendim të posacëm të asmblesë së ortakëve sipas nenit 86 te Ligjt nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhc shoqëritë tregtare".
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij nenit, duhet të jetë i përshtatshëm dhc në përputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare të shoqërisë dhc të respektojë nivelet minimale të kërkua nga legjislacioni në fuqi.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **NENI 31** **DETYSIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA**

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjt Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhc shoqerite tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mqedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - c) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

- d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtartet dhe shoqëritë tregtare".
- këtij ligji;
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave të mesiperme të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.
  4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshtë i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:
    - a) i kthen ortakëve kontributet;
    - b) i paguan ortakëve interesa apo dividendë;
    - c) i shpërndajnë aktivet shoqërisë;
    - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
    - d) jep kredi.
  5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafet e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 (tre) vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

## TITULLI V

### PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

#### KREU I

#### PRISHJA E SHOQËRISË

#### NENI 32 SIKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE

1. Shoqeria me pernjegjesi te kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohezgjatja, per te cilin eshte themeluar;
- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
- c) ne rast se objekti behet i parcalizueshem per shkak te mosfunkcionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimitarise tregtare;

- d) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga nen 3/1 i ligjit tregtar;
  - e) ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;
  - f) ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;
  - g) per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve.
2. Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", te pikes 1, te ketij nen, vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87, te ketij ligji.
3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara me siper, edo person i interesuar mund, ne cdo kohe, ti drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.
4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistencë e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara ne kete nen, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, shkaku i prishjes eshte korrigjuar, nese eshte e mundshme te korrigojet, dhe ky korrigim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.
5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij nen, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te kelyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendos irrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.
6. Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te ketij nen, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ligjit tregtar.

### NENT 33 REGJISTRIMI I SHPERBERJES

1. Administratori ka detyre te regjistroje shperberjen e shoqerisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqerisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.
2. Ne rastin e shperberjes se shoqerise, pavaresisht institucionit që ka marre vendimin asamblese dhe/ose gjykates, ngarkohet administratori që te kryeje procedurat deri ne perfundim te ketij procesi, per aq kohe sa, kjo dispozite e statutit nuk vjen ne kundershtim me legjisacionin ne fuqi.

**KREU II**  
**LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

**NENI 34**  
**LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESTIME**

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqerinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.
3. Administratori duhet të thërrase mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i anullohet dhe/ose likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

**NENI 35**  
**PERJASHTIMI I ORTAKUT**

1. Asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:
  - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë osc ortakëve të tjerë;
  - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
  - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
  - d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprintarinë tregtare të shoqërisë.
  - e) Mungon per me shume se dy mbledhje rresht ne asamblene e përgjithshme, duke mosmarre pjesë persoanlisht e as me perfaquesues, ne menyre te pa justifikuar, dhe pa njoftim paraprak, megjithese ka pasur njoftim te rregullt sipas parashikimeve te ketij statuti.

3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkcsë të paditësit, gjykata mund të manë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërbirim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonë në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

**NENI 36**  
**PASOJAT E LARGIMIT DIHE PERJASHTIMIT**

1. Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
2. Statut nuk mund të përjashtojë apo të kusizojë të drejtën e ortakut për tu larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

**NENI 37**  
**LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE**

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kusizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftesise paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

**NENI 38**

**Dispozita tranzitore dhe të fundit**

1. Per cdo gje qe nuk eshte parashikuar shprehimi i statutit qe lidhet me funksionimin e shoqerise, zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te ketij satuti.
2. Ne cdo rast kur legjislacioni shqiptar perkates mund te ndryshoje, ky statut me vendim te asamblese se ortakeve, sipas rregullave te percaktuara mund te ndryshohet, ne perputhje me ndryshimet perkatesc te legjislacionit ne fuqi.
3. Ky statut hartohet ne tre kopje origjinale, dhe hyn ne fuqi per palet nenshkruese nga data e nenshkrimit te tij dhe prodhon efekte ndaj te treteve nga data e rregjistrimit te tij ne QKB.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERIS XPRESS GUARDS SECURITY SHPK**

Gjergji Spiro Shaka

  
\_\_\_\_\_  
Emri Mbiemri Firme  
